

RAPORT BRIEF · AO-FIS-26-008-B

Barra Tatimore 2025 dhe Dita e Lirisë Fiskale 2026

Analizë Krahasuese Rajonale për Ballkanin Perëndimor (WB6)

Shqipëri · Kosovë · Serbi · Bosnjë-Hercegovina · Mali i Zi · Maqedonia e Veriut

Prill 2026 | Raporti i 14-të Vjetor ALTAX | © ALTAX

ABSTRAKT

Ky Raport Brief përmbledh gjetjet kryesore të Raportit të 14-të Vjetor ALTAX mbi Barrën Tatimore 2025 dhe Ditën e Lirisë Fiskale 2026 në gjashtë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (WB6). Analiza krahasuese eidenton se barra totale tatimore varion nga 26.4% e PBB-së në Kosovë deri në 38.8% në Bosnjë-Hercegovinë, me mesatare rajonale 32.2%, dukshëm nën mesataren e BE-27 prej rreth 41%. Megjithatë, faktori kryesor dallues ndërmjet vendeve nuk është niveli total i barrës, por struktura e saj dhe efekti rishpërndarës. Raporti propozon paketën prioritare të reformave "Punësimi Formal 2027" për Shqipërinë, me efekte kumulative deri në +14 miliardë lekë të ardhura shtesë, +48.000–62.000 vende pune formale të reja dhe reduktim të informalitetit me 6.2 pikë përqindjeje deri në 2028.

Fjalëkyçe: barra tatimore, Dita e Lirisë Fiskale, WB6, reformë fiskale, informalitet, punësim formal, Shqipëri

1. KONTEKSTI DHE RËNDËSIA

Periudha 2022–2025 shënoi një rimëkëmbje të qëndrueshme, por të pabarabartë për rajonin WB6. Rritja ekonomike mesatare u stabilizua rreth 3.1–3.8%, inflacioni u normalizua nga 9.8% (2022) në ~3.0% (2025) dhe investimet e huaja direkte u rritën me 44.9% kumulative. Megjithatë, tkurrja demografike prej 4.8%, ku popullsia rajonale ra nga 17.34 milionë (2022) në 16.50 milionë (2025) dhe emigracioni i lartë i fuqisë punëtore mbeten sfidat strukturore më serioze.

Barra tatimore është treguesi kyç i cilësisë së politikës fiskale dhe i marrëdhënies midis shtetit dhe qytetarit. Ajo ndikon drejtpërdrejt fuqinë blerëse të familjeve, vendimet e investimit, formalizimin e ekonomisë dhe besimin publik ndaj institucioneve. Katër arsye e bëjnë analizën e 2025–2026 veçanërisht strategjike: (i) rimëkëmbja post-pandemike mbetet e brishtë; (ii) procesi i integritit europian kërkon harmonizim fiskal; (iii) vitet 2025–2026 janë periudhë vendimmarrëse për paketat fiskale; dhe (iv) barra tatimore ndikon drejtpërdrejt besimin e qytetarëve ndaj institucioneve.

2. BARRA TATIMORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2025

2.1 Nivelet dhe Struktura Tatimore

Rajoni WB6 paraqet një gamë të gjerë nivelesh tatimore, por me një karakteristikë të përbashkët, dominimin e taksave indirekte (TVSH dhe akciza) dhe kontributeve shoqërore, të cilat bashkërisht zënë 70–75% të totalit tatimor. Tatimet direkte (PIT + CIT) luajnë rol shumë të kufizuar, me përjashtim të Serbisë.

Vendi	Barra Tatimore (% PBB)	TVSH (% totalit)	Kontributet (% totalit)	Tax Wedge (%)
Kosovë	26.4%	51.5%	~10%	~15%
Shqipëri	27.0%	34.1%	24.2%	39–42%
Maqedonia e Veriut	30.0%	~36%	~30%	~40%
Mali i Zi	35.4%	~28%	~22%	~43%
Serbi	35.9%	~30%	~33%	~52%

Vendi	Barra Tatimore (% PBB)	TVSH (% totalit)	Kontributet (% totalit)	Tax Wedge (%)
Bosnjë-Hercegovina	38.8%	~40%	~41%	~47%
Mesatare WB6	32.2%	~37%	~28%	~38–45%

Tabela 1. Barra Tatimore dhe Struktura, WB6 2025 | Burimi: DPT, ATK, FMN, Eurostat, Ilogaritjet ALTAX

2.2 Gjetjet Kryesore Rajonale

- Barra totale tatimore** varion nga 26.4% (Kosovë) deri në 38.8% (Bosnjë-Hercegovina), me mesatare rajonale 32.3%, dukshëm nën mesataren e BE-27 (41%).
- Dominimi i TVSH-së dhe akcizave, ku** Kosova ka varësinë më të lartë (51.5% e totalit tatimor nga TVSH-ja), ndjekur nga Bosnja (40%). Shqipëria ka 34.1% dhe mbi mesataren e BE-27 (~27%).
- Barra mbi punën (tax wedge).** Shumica e vendeve WB6 kanë tax wedge 38–52%, me Serbinë (52%) si rastin ekstrem. Kjo ngarkesë nxit punën e padeklaruar dhe emigracionin e fuqisë punëtore.
- Tatimet direkte (PIT + CIT),** mbeten shumë të ulëta në të gjithë rajonin, me përjashtim të Serbisë. Kjo e bën sistemin tatimor rajonalisht regresiv dhe me efekt rishpërndarës të kufizuar.

3. DITA E LIRISË FISKALE 2026

Dita e Lirisë Fiskale (Fiscal Freedom Day — DLF) tregon ditën e vitit kur qytetari mesatar ka "paguar" të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit. Çdo ditë para DLF-së, punëtori mesatar "punon për shtetin"; çdo ditë pas saj, punon për veten. ALTAX e ka publikuar këtë tregues çdo vit për Shqipërinë dhe e zgjeron tani në të gjithë rajonin WB6.

Vendi	Barra Tatimore (% PBB)	Dita e Lirisë Fiskale 2026	Ditë pune për shtetin
Kosovë	26.4%	6 Prill	96 ditë
AL Shqipëri	27.0%	9 Prill	99 ditë
Maqedonia e Veriut	30.0%	19 Prill	109 ditë
Mali i Zi	35.4%	28 Prill	118 ditë
Serbi	35.9%	8 Maj	128 ditë
Bosnjë-Hercegovina	38.8%	22 Maj	142 ditë

Tabela 2. Dita e Lirisë Fiskale WB6, 2026 | Burimi: Ilogaritjet ALTAX

Distanca prej 46 ditësh ndërmjet Kosovës (6 Prill) dhe Bosnjës (22 Maj) korrespondon me 12.6 pikë përqindje diferencë tatimore si % e PBB-së, ekuivalente me 700 EUR barrë tatimore shtesë vjetore për punëtorin mesatar boshnjak krahasuar me atë kosovar.

Në Shqipëri (9 Prill), qytetari mesatar shqiptar punon 99 ditë në vit vetëm për taksa dhe kontribute. Ky pozicion i favorshëm rajonal nuk reflekton domosdoshmërisht efikasitet sistematik, por kryesisht nivelin e ulët relativ të barrës totale.

4. ANALIZË E THELLUAR PËR SHQIPËRINË

4.1 Performanca Fiskale 2025

Shqipëria paraqitet në 2025 si njëra nga ekonomitë më dinamike dhe fiskalisht performante të WB6. Të ardhurat tatimore neto të DPT-së arritën 428 miliardë lekë (+11.7% krahasuar me 2024), me rritje të theksuar të TAP-it (+23.9%) dhe TVSH-së neto (+15%). Ky rezultat reflekton progresin e formalizimit të ekonomisë dhe forcimin e administrimit tatimor.

Burimi i të Ardhurave	Mld lekë	% e tot.	% e PBB	Plan 2025	Ndryshim vs 2024
TVSH (neto)	227.3	34.1%	8.7%	226.7	+6.2%
TAP (Tatimi mbi të Ardhurat Personale)	82.7	11.2%	3.2%	84.2	+24.8%
TF (Tatimi mbi Fitimin)	58.7	7.9%	2.3%	60.4	+2.7%
Kontributet shoqërore & shëndetësore	179.1	24.2%	6.7%	177.7	+10.9%
Akciza	69.6	9.4%	2.7%	70.9	+9.7%
Taksa kombëtare + Tarifa	24.6	3.3%	1.8%	47.1	+2.9%
Taksa vendore	40.9	5.5%	1.6%	40.8	+1.4%
TOTAL bruto të ardhura	741.6	100%	27%	743.4	+8.7%

Tabela 3. Struktura e Të Ardhurave Tatimore Bruto, Shqipëri 2025 | Burimi: DPT Raporti Vjetor 2025, Ilogaritjet ALTAX

4.2 Sfidat Strukturore Kryesore

Pavarësisht performancës pozitive në mbledhje, sistemi fiskal shqiptar paraqet tre sfida strukturore të rëndësishme që cenojnë qëndrueshmërinë afatgjatë:

- **Përqendrim gjeografik ekstrem, me** 69% e të gjitha të ardhurave tatimore bruto vijnë nga Tirana dhe Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM). Tirana+Durrësi zënë 74.2% të totalit fiskal kombëtar — një nga nivelet më të larta të centralizimit fiskal në Europën Juglindore.
- **Regresivitet i lartë, ku** TVSH-ja (34.1% e totalit) dhe akcizat (9.4%) zënë mbi 43% të të ardhurave totale. Familjet me të ardhura të ulëta shpenzojnë 80–90% të të ardhurave për konsum dhe paguajnë proporcionalisht shumë më shumë TVSH si % e të ardhurave.
- **Barrë e lartë mbi punën.** Tax wedge 39–42% (kontribute shoqërore 27.9% + TAP progresive) — mbi mesataren e vendeve me barra të ngjashme totale si Rumania (~35%) dhe Bullgaria (~38%). Ky nivel nxit punën e padëklaruar dhe informalitetin (24.2% e PBB-së).

5. PABARAZIA, PROGRESIVITETI DHE NDIKIMI SOCIAL

Efekti redistributiv i sistemeve tatimore në WB6 është i moderuar. Serbia ka reduktimin më të madh të koeficientit Gini para/pas taksave (nga ~0.42 para-taksa në ~0.33 pas-taksa, reduktim 9 pp), duke reflektuar sistemin relativisht më progresiv. Kosova dhe Shqipëria kanë vlerat më të ulëta të Gini-t pas taksave (~0.29), por kjo vjen kryesisht nga nivelet e ulëta të pagave dhe jo nga rishpërndarja fiskale efektive.

Dy elementë kryesorë kontribuojnë në regresivitetin e sistemit fiskal shqiptar: (i) TVSH-ja me normë uniforme (pa diferencim të mjaftueshëm për mallra bazë), e cila godet proporcionalisht më shumë shtresat me të ardhura të ulëta; dhe (ii) kontributet shoqërore me tavan (regressivë për pagat e larta, mbi tavan nuk kontribuojnë). Ky kombinim krijon efektin paradoksal, ku sistemi mbledh të ardhura, por nuk i rishpërndan ato.

6. PROPOZIMET E REFORMAVE FISKALE

6.1 Paketa Prioritare "Punësimi Formal 2027" (Skenari 1)

Analiza e pesë skenarëve fiskale konfirmon se Skenari 1 — "Punësimi Formal 2027" prodhon rezultatin optimal sipas të katër dimensioneve (të ardhura buxhetore, punësim formal, ulje pabarazie dhe reduktim informaliteti). Zbatimi i tij nuk kërkon rritje të barrës totale tatimore:

- **Masa kryesore 1** - Ulje e kontributeve shoqërore nga 27.9% në 23% për pagat deri 80,000 lekë/muaj (e kompensuar me rritje të taksës mbi pasuri të paluajtshme nga 0.15% në 0.35% për pasuri >30 milionë lekë).
- **Masa kryesore 2** - Diferencim i TVSH-së me 15% për mallra bazë (ushqim, ilaçe, energji shtëpiake) + 22% për produkte luksoze, që bie reduktim regresiviteti me neutralitet fiskal.

- **Masa kryesore 3** - Tatim mbi fitimin diferencuar me 18% për ndërmarrje me xhiro >500 milionë lekë + 3% për SME-të e reja (2 vitet e para).
- **Masa kryesore 4** - Futja e tatimit minimal global 15% për multinacionale (OECD BEPS Pillar 2) + decentralizim fiskal i kontrolluar (nga 5.6% drejt 7–8% e PBB-së).

6.2 Krahasim i Skenarëve Fiskale (Efekte Kumulative 2026–2028)

Skenari	Të ardhura bux.	Punësim formal	Ulje Gini	Ulje informalit.
★ Sk.1 — Punësimi Formal 2027 (PRIORITET)	+14.0 mld lekë	+48.000–62.000	-1.7–2.1 pp	-6.2%
Sk.2 — TVSH Progressive	+4.3 mld lekë	+19.000–26.000	-1.3–1.6 pp	-3.8%
Sk.3 — TF Diferencuar	+6.4 mld lekë	+24.000–31.000	-0.8–1.1 pp	-2.9%
Sk.4 — TF + Tatim Global Min. 15%	+6.4 mld lekë	+24.000–31.000	-0.8–1.1 pp	-2.9%
Sk.5 — Status quo (pa reformë)	0	+11.000–14.000	-0.3 pp	-1.1%

Tabela 4. Krahasim i 5 Skenarëve — Efektet Kumulative 2026–2028 | Burimi: simulim ALTAX, DPT 2025

Kombinimi optimal - Skenari 1 + Skenari 4 jep efektin kumulativ maksimal deri 2028 me rritje të konsiderueshme të punësimit formal, ulje të ndjeshme të pabarazisë, reduktim të informalitetit dhe të ardhura shtesë, pa rritje të barrës tatimore totale.

Kosto e shtyrjes - Çdo vit vonesë në zbatim kostojnë rreth 8.000–12.000 vende pune formale të humbura dhe ~4 miliardë lekë të ardhura shtesë të pagjeneruara.

7. ROADMAP FISKALE 2026–2028

2026 Nisja	<ul style="list-style-type: none"> • Adoptimi ligjor i Skenarit 1 me ulje kontributeve shoqërore 27.9% → 23% • Hyrja në fuqi e tatimit minimal global 15% (OECD BEPS Pillar 2) • Diferencimi i TVSH-së me 15% mallra bazë, 22% produkte luksoze • Faturim elektronik obligator i zgjeruar + auditim me AI
2027 Konsolidimi	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjerim i bazës tatimore të TAP-it dhe TF, reduktim i përjashtimeve • Rritje graduale e taksës mbi pasuri me 0.15% → 0.35% (pasuri >30 mln lekë) • Decentralizim fiskal, si hapat reformuesë të autonomisë tatimore lokale • Matja e efekteve të Skenarit 1 dhe korigjim sipas rezultateve
2028 Qëndrueshmëria	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikim i plotë i strukturës tatimore drejt standardeve BE-27 • Objektivi - Tax-to-GDP 29–30% (nga 27% sot) • Objektivi - Gini index <0.28 (nga 0.30 sot) • Objektivi - Informalitet <20% e PBB-së (nga 24.2% sot)

8. KONKLUZIONE DHE MESAZHE POLITIKE

Ky raport konfirmon se WB6 ka arritur stabilizim makroekonomik të rëndësishëm, por sfida strukturore fiskale mbeten serioze. Ndryshimi ndërmjet vendeve nuk qëndron kryesisht tek niveli total i barrës tatimore, por tek struktura e saj dhe efekti rishpërndarës. Pesë mesazhe kryesore drejtuar vendimmarrësve:

1

Mesazhi 1 — Struktura, jo niveli total, është problemi kyç.

WB6 ka barra tatimore dukshëm nën mesataren e BE-së, por me sisteme shumë regresive. Dominimi i TVSH-së dhe kontributeve shoqërore (70–75% e totalit) ndërkohë tatimet direkte luajnë rol shumë të kufizuar.

2

Mesazhi 2 — Barra mbi punën është pengesë kryesore e formalizimit.

Tax wedge 39–52% në shumicën e vendeve nxit informalitetin dhe emigracionin e fuqisë punëtore. Reformimi i kësaj barre — si model Mali i Zi 2022 — është hapi më urgjent.

3

Mesazhi 3 — Shqipëria ka hapësirë dhe nevojë për reformë strukturore.

Sistemi aktual me 69% të ardhurave nga Tirana+DTM, barrë mbi punën 39–42%, TVSH 34.1% dhe informalitet 25.5% nuk është i qëndrueshëm afatgjatë. TAP +23.9% tregon se formalizimi funksionon.

4

Mesazhi 4 — Skenari 1 "Punësimi Formal 2027" është zgjedhja optimale.

+14 miliardë lekë të ardhura kumulative, +48.000–62.000 vende pune formale dhe ulje informaliteti 6.2% deri 2028, pa rritje të barrës totale tatimore.

5

Mesazhi 5 — Zbatimi kërkon vendimmarrje të guximshme tashmë në 2026.

Çdo vit vonesë kostojnë rreth 8.000–12.000 vende pune formale të humbura dhe 4 miliardë lekë të ardhura shtesë të pagjeneruara.

Shqipëria dhe rajoni kanë mundësi konkrete për të përshpejtuar konvergencën europiane nëpërmjet reformave fiskale të bazuara në evidencë. Çelësi nuk është rritja e normave tatimore, por ribalancimi i strukturës me kalim nga taksat regresive mbi konsum dhe punë drejt taksave progresive mbi pasuri dhe kapital.